REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 01 datë 29.04.2026

PËR
MIRATIMIN E LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN: "NDËRTIMI I SEGMENTIT TË RI TË LINJËS 110 KV", ME VENDNDODHJE PRANË NËNSTACIONIT AKËRNI, BASHKIA VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin:"Ndërtimi i segmentit të ri të linjës 110 kV", me vendndodhje pranë Nënstacionit Akërni, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 01 /10/ 2026